



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 22 qershor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 19 qershor 2020, pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ("Vendimi i Konfirmimit"),² Prokurori i Specializuar dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar.³
2. Më 16 mars 2021, pas vendimit dhe fletarrestimit të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake,⁴ Pjetër Shala ("z. Shala" ose "i akuzuari") u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës ("Belgjikë").⁵

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës Kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u lëshuan më 6 maj 2021, F00007/CONF/RED dhe F00007/RED).

³ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale (Versioni konfidencial me më pak redaktime dhe versioni publik i redaktuar më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzuan më 31 mars 2021, F00016/A01, konfidencial, F00016/A02, publik. Një version tjetër konfidencial me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 25 maj 2021, F00038/A01. Pas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi mocionin e Mbrojtjes që kundërshton formën e Aktakuzës së Konfirmuar, u dorëzua aktakuza e korrigjuar më 1 nëntor 2021, F00098/A01, konfidenciale, dhe 16 nëntor 2021, F00107/A01, publike).

⁴ KSC-BC-2020-04, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 6 maj 2021, F00008/RED); F00008/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestim për z. Pjetër Shala*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar publik u lëshua më 15 prill 2021, F00008/A01/RED).

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

3. Më 15 prill 2021, pas përfundimit të procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.⁶
4. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën për lirim të përkohshëm të parashtruar nga Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") ("Vendimi i Parë i Paraburgimit").⁷ Gjykata e Apelit e konfirmoi Vendimin e Parë të Paraburgimit më 20 gusht 2021 ("Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit").⁸
5. Më 10 shtator 2021, 10 nëntor 2021 dhe 28 janar 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rishikoi paraburgimin e z. Shala dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij (përkatësisht "Vendimi i Dytë i Paraburgimit", "Vendimi i Tretë i Paraburgimit" dhe "Vendimi i Katërt i Paraburgimit").⁹
6. Më 11 shkurt 2022, Gjykata e Apelit ia ktheu Vendimin e Tretë të Paraburgimit Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shqyrtim të mëtejshëm, për të kërkuar parashtrime shtesë nga Administratorja lidhur me rregullat e paraburgimit në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe për të ftuar Mbrojtjen që të kërkonte informacion mbi gatishmërinë dhe mundësitë e Belgjikës për të zbatuar kushtet për

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit*, 15 prill 2021, konfidencial, para. 2, me Shtojcat 1-2, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 26 prill 2021, F00019/RED).

⁷ KSC-BC-2020-04, F00045, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Pjetër Shalës për Lirim të Përkohshëm*, 15 qershor 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua më 23 qershor 2021, F00045/RED).

⁸ KSC-BC-2020-04, IA001/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës Kundër Vendimit në Lidhje me Lirimin e Përkohshëm*, 20 gusht 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, IA001/F00005/RED).

⁹ KSC-BC-2020-04, F00075, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 shtator 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, F00075/RED); F00105, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 nëntor 2021, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, F00105/RED); F00133, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 28 janar 2022, konfidencial (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, F00133/RED).

lirim të propozuara nga z. Shala, ose çfarëdo kushtesh shtesë (“Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit”).¹⁰

7. Më 22 prill 2022, pas parashtrimeve të mëtejshme nga Administratorja, autoritetet belge dhe palët, dhe duke pasur parasysh se z. Shala hoqi dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit para përfundimit të afatit të përcaktuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores,¹¹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin mbi Vendimin e Tretë të Paraburgimit të kthyer për rishikim dhe mbi rishikimin periodik të paraburgimit të z. Shala, duke urdhëruar vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit (“Vendimi i Pestë i Paraburgimit”).¹²

8. Më 4 maj 2022, Mbrojtja e apeloit Vendimin e Pestë të Paraburgimit.¹³ Gjykata e Apelit ende nuk ka marrë vendim.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, IA003/F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 11 shkurt 2022, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua të njëjtën ditë, IA003/F00005/RED).

¹¹ KSC-BC-2020-04, F00145, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër Drejtuar Administratores për Dorëzim të Informacionit mbi Regjimin e Paraburgimit Pjetër Shalës*, 14 shkurt 2022, publik, para. 9-11, me Shtojcën 1, publike; F00152, Administratorja, *Parashtrime të Zyrës Administrative në Përputhje me Urdhrin për Paraqitjen e Informacionit për Regjimin e Paraburgimit (F00145)*, 22 shkurt 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 22 prill 2022, F00152/RED); F00160, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Parashtrimet për Rishikimin e Ardhshëm të Paraburgimit*, 1 mars 2022, publike; Transkripti, 4 mars 2022, publike, f. 189-190; F00171, Mbrojtësi i Specializuar, *Parashtrime të Mbrojtjes për Rishikimin e Paraburgimit dhe Përgjigje ndaj Urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 30 mars 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 prill 2022, F00171/RED); F00177, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Rishikimin e Pestë të Paraburgimit*, 7 prill 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u lëshua më 22 prill 2022, F00177/RED); F00184, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj ‘Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Pestë të Paraburgimit’*, 12 prill 2022, publike; F00185, Administratorja, *Përcjellje e Korrespondencës*, 19 prill 2022, publike, me dy shtojca, konfidenciale.

¹² KSC-BC-2020-04, F00188, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Mbajtjes në Paraburgim të Pjetër Shalës*, 22 prill 2022 (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, F00188/RED).

¹³ KSC-BC-2020-04, IA005/F00001, Mbrojtësi i Specializuar, *Apel i Mbrojtjes kundër Vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës të datës 22 prill 2022*, 4 maj 2022, konfidencial.

9. Më 8 qershor 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrimet e saj mbi rishikimin e paraburgimit të z. Shala ("Parashtrimet e ZPS-së").¹⁴ Mbrojtja u përgjigj më 15 qershor 2022 ("Përgjigja e Mbrojtjes").¹⁵

II. PARASHTRIMET

10. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit mbetet i domosdoshëm dhe proporcional.¹⁶ Ajo pretendon se nuk është paraqitur asnjë fakt apo rrethanë e re që mund të ndryshojë konstatimet e arritura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në Vendimin e Pestë të Paraburgimit.¹⁷ Sa i përket rreziqeve, ZPS-ja parashtron se ato janë shtuar me afrimin e kohës kur çështja do t'i kalojë Trupit Gjykses dhe ato mund të zvogëlohen dhe të kontrollohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.¹⁸

11. Mbrojtja parashtron se lirimi i përkohshëm i z. Shala është i përligjur sepse: (i) ZPS-ja nuk i ka vërtetuar rreziqet e pretenduara sipas nenit 41(6) të Ligjit, veçanërisht pretendimin për rrezikun e shtuar si rezultat i kalimit të pritshëm të dosjes së çështjes tek Trupi Gjykses; dhe (ii) paraburgimi i zgjatur i z. Shala në pritje të gjykimit nuk është as i domosdoshëm e as proporcional.¹⁹ Rrjedhimisht, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake që t'i japë fund vazhimit të paraburgimit të z. Shala dhe të urdhërojë lirimin e tij të përkohshëm ose vendosjen në arrest shtëpiak [REDAKTUAR] nën kushte që konsiderohen të përshtatshme.²⁰

¹⁴ KSC-BC-2020-04, F00213, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Rishikimin e Gjashtë të Paraburgimit*, 8 qershor 2022, konfidenciale.

¹⁵ KSC-BC-2020-04, F00221, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj "Parashtrimeve të Prokurorisë për Rishikimin e Gjashtë të Paraburgimit"*, 15 qershor 2022, konfidenciale.

¹⁶ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 1, 10, 12.

¹⁷ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 1.

¹⁸ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 5-9.

¹⁹ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 2-3, 11-12, 14-15.

²⁰ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 18.

III. DISPOZITAT LIGJORE TË ZBATUESHME

12. Neni 41(6) i Ligjit parasheh që DHS-ja urdhëron paraburgimin e personit vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së, dhe ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) ka rrezik të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova të veprës penale, ose rrethana konkrete sugjerojnë se personi do të pengojë zhvillimin e procedurave penale; ose (iii) do ta përsërisë veprën penale, përfundojë një vepër penale në tentativë, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

13. Neni 41(10) i Ligjit parasheh që, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirim, me kalimin e dy (2) muajve pas vendimit të fundit për mbajtjen në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykues i ngarkuar me çështjen shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim dhe lëshon vendim me të cilin e vazhdon ose e përfundon mbajtjen në paraburgim. Kjo gjithashtu rrjedh nga rregulla 57(2) e Rregullores.

14. Neni 41(12) i Ligjit parasheh që, përveç mbajtjes në paraburgim, mund të urdhërohen masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e kryerjes së veprës penale, ose për të siguruar zhvillim të suksesshëm të procedurave penale: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania me kusht, arresti shtëpiak, premtimi që të mos largohet nga vendbanimi, ndalimi që t'i afrohet vendeve apo personave të caktuar, paraqitje në stacion policor apo në ndonjë vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

15. Në përputhje me rregullën 56(2) të Rregullores, paneli siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes dhe, në rast vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pas dëgjimit të palëve, paneli mund ta lirojë personin me kushte që konsiderohen të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

16. ZPS-ja parashtroi se, për qëllime të rishikimit të paraburgimit sipas rregullës 57(2) të Rregullores, duhet të rishikohen arsyet apo rrethanat në të cilat bazohet paraburgimi, për të përcaktuar nëse këto arsye vazhdojnë të ekzistojnë sipas nenit 41(6) të Ligjit.²¹ Sipas mendimit të ZPS-së, ky përcaktim ka të bëjë pashmangshmërisht me ndryshimet që kanë ndodhur, nëse ka pasur të tilla, që nga vendimi i mëparshëm për paraburgim.²² ZPS-ja gjithashtu pretendon se nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kërkohet që të bëjë konstatime lidhur me faktorët për të cilët tashmë është marrë vendim në vendimin fillestar për paraburgim, dhe se nuk ka pasur ndryshime që nga vendimi i fundit për paraburgimin.²³

17. Mbrojtja fton Gjykatësin e Procedurës Paraprake që të bëjë një rishikim efektiv të ligjshmërisë së vazhdimit të paraburgimit dhe t'i kërkojë ZPS-së të demonstrojë domosdoshmërinë e paraburgimit në bazë të rreziqeve serioze dhe ekzistuese që paraqet mundësia e lirimit të përkohshëm.²⁴ Mbrojtja parashtroi se mbajtja në paraburgim duhet të jetë përjashtim, të jetë rreptësisht e domosdoshme dhe të lejohet vetëm në rastet kur nuk ekzistojnë masa alternative që do të zvogëlonin rrezikun që paraqet lirimi i përkohshëm.²⁵ Sipas Mbrojtjes, prezumimi në favor të pafajësisë së z. Shala dhe e drejta e tij të jetë i lirë në pritje të gjykimit duhet të formojnë bazën e çfarëdo vlerësimi për ekzistencën e ndonjë rreziku serioz dhe real që paraqet lirimi i përkohshëm.²⁶

18. Mbrojtja gjithashtu parashtroi se ZPS-ja e keqinterpretonte standardin e zbatueshëm dhe ia kalon në mënyrë të papranueshme detyrimin e vërtetimit

²¹ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 3.

²² Parashtrimet e Prokurorisë, para. 3.

²³ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 3.

²⁴ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 4.

²⁵ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 8.

²⁶ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 8.

Mbrojtjes, duke argumentuar se Mbrojtja nuk ka “identifikuar asnjë ndryshim relevant të rrethanave që nga vendimi i fundit”.²⁷ Sipas Mbrojtjes, supozimi se cilido i akuzuar në pritje të gjykimit mund të mbahet për aq sa mund të zgjasë gjykimi për shkak të rrethanave të “pandryshuara” është “qartësisht i gabuar dhe thellësisht i padrejtë”.²⁸ Mbrojtja parashtron se është përcaktuar qartë se “ZPS-ja duhet të japë argumente dhe prova konkrete për të përcaktuar se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm në kohën e rishikimit”,²⁹ sepse me nenin 41(6)(b) të Ligjit kërkohet që provat të përmbushin një standard lartë për të hedhur poshtë prezumimin e lirimit të përkohshëm në pritje të gjykimit.³⁰

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se e ka obligim, sipas nenit 41(10) të Ligjit, të shqyrtojë nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim, përfshirë arsyet e përcaktuara me nenin 41(6) të Ligjit, konkretisht: (i) nëse ekziston dyshimi i bazuar që personi ka kryer krim(e); dhe (ii) nëse ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se është përmbushur ndonjëri nga rreziqet e përcaktuara me nenin 41(6)(b) të Ligjit.³¹ Detyra për të përcaktuar nëse ende ekzistojnë rrethanat në të cilat bazohet paraburgimi i imponon panelit kompetent që, *proprio motu*, të shqyrtojë nëse, në kohën e rishikimit dhe në rrethanat konkrete të çështjes në kohën kur kryhet rishikimi, ai është ende i bindur se paraburgimi i të akuzuarit vijon të jetë i nevojshëm.³² Edhe pse rishikimi i rregullt çdo dy muaj sipas rregullës 57(2) të Rregullores nuk është rreptësisht i kufizuar në atë nëse ka pasur ndryshim të rrethanave, një ndryshim i tillë

²⁷ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 9, *ku përmenden* Parashtrimet e Prokurorisë, para. 3. *Shih gjithashtu* Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 10.

²⁸ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 15.

²⁹ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 10, *ku përmendet* Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 25.

³⁰ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 11, 15.

³¹ KSC-BC-2020-07, IA002-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit* (“Apeli i Paraburgimit të Haradinajt”), 9 shkurt 2021, publik, para. 55; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 16; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 25.

³² KSC-BC-2020-06, IA006-F00005, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit* (“Vendimi i Apelit të Krasniqit”), 1 tetor 2021, konfidencial, para. 15 (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, IA006/F00005/RED); Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 17; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 25.

megjithatë mund të jetë përcaktues dhe merret parasysh nëse ngrihet nga një palë, ose *proprio motu*.³³ Paneli mund t'u referohet konstatimeve në vendimet e mëparshme nëse bindet se provat ose informacioni në të cilat bazohen ato vendime ende i mbështesin konstatimet e bëra në kohën e rishikimit.³⁴ Nuk kërkohet që të bëhen konstatime për faktorë për të cilët tashmë është vendosur në vendimin fillestar mbi paraburgimin, dhe as të konsiderohen parashtrimet që vetëm përsërisin argumentet që janë trajtuar tashmë në vendime të mëparshme.³⁵ ZPS-ja ka detyrimin që të vërtetojë se paraburgimi i të akuzuarit është i domosdoshëm.³⁶ Kjo do të thotë se ZPS-ja duhet të paraqesë argumente të caktuara dhe prova konkrete për të përcaktuar se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm në kohën e rishikimit.

20. Në kundërshtim me argumentin e Mbrojtjes, parimet e përcaktuara në paragrafin paraardhës shprehimisht përcaktojnë se detyrimi i vërtetimit i takon ZPS-së dhe Parashtrimet e ZPS-së nuk përcaktojnë ndryshe.³⁷ Gjithashtu, këto parime janë të përcaktuara qartë në jurisprudencë dhe nuk e zhvlerësojnë garancinë sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores.³⁸

B. DYSHIMI I BAZUAR

21. Sa i përket standardit për vazhdimin e paraburgimit, me nenin 41(6)(a) të Ligjit kërkohet, që në fillim, ekzistencën e dyshimit të bazuar se personi i paraburgosur ka kryer krim brenda juridiksionit të DHS-së. Ky është kusht *sine*

³³ Apeli i Paraburgimit të Krasniqit, para. 16; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 18; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 25.

³⁴ Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 18; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 25.

³⁵ Apeli i Paraburgimit të Haradinajt, para. 55; Apeli i Paraburgimit të Krasniqit, para. 17; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 18; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 25.

³⁶ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 13, me referenca të mëtejshme; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 25.

³⁷ *Shih gjithashtu* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 15.

³⁸ Faktikisht, një kundërshtim i ngjashëm nga Mbrojtja i jurisprudencës së Gjykatës së Apelit u hodh poshtë kohët e fundit, *shih* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 15-18.

qua non për vlefshmërinë e vazhimit të paraburgimit të personit të paraburgosur.³⁹

22. ZPS-ja parashtron se, për arsyet e paraqitura në Vendimin e Konfirmimit dhe Vendimin e Pestë të Paraburgimit, ende ekziston dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer disa krime brenda juridiksionit të DHS-së, duke e tejkaluar kështu standardin e dyshimit të bazuar që kërkohet për qëllimet e nenit 41 të Ligjit.⁴⁰ Ajo shton se nuk ka pasur zhvillime që mund të ndryshojnë këtë konstatim ose të arsyetojnë rishqyrtimin e tij nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴¹

23. Ndërsa u qëndron parashtrimeve të saj të mëparshme mbi kundërligjshmërinë e vazhimit të paraburgimit të z. Shala,⁴² Mbrojtja nuk e trajton konkretisht këtë kriter.

24. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në Vendimin e Konfirmimit, u konstatua se, në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Shala është penalisht përgjegjës për një numër krimesh lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje) sipas neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit.⁴³ Këto konstatime janë bërë në bazë të një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.⁴⁴

25. Në mungesë të ndonjë informacioni ose zhvillimi të ri në lidhje me vendimin aktual, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ende është i përmbushur kriteri i përcaktuar me nenin 41(6)(a) të Ligjit.

³⁹ *Ngjashëm* ECtHR, *Merabishvili v. Georgia* [GC], no. 72508/13, [Judgment](#), 28 November 2017, para. 222, me referenca të mëtejshme.

⁴⁰ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 2, 4.

⁴¹ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 4.

⁴² Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 7.

⁴³ Vendimi i Konfirmimit, para. 140(a). *Shih gjithashtu* Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 15; Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 22; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 19; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 21; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 30.

⁴⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 35. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, IA008-F00004, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 1 tetor 2021, konfidencial, para. 21 (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, IA008/F00004/RED).

C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

26. Kur përmbushet standardi i nenit 41(6)(a) të Ligjit, arsyet që justifikojnë heqjen e lirisë së personit duhet të jenë të artikulueshme në kuptimin që duhet të saktësohen në hollësi.⁴⁵ Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu përkujton se, në bazë të provave në dispozicion, arsyet konkrete të artikulueshme duhet të mbështesin “besimin”⁴⁶ se ekziston ndonjëri prej rreziqeve të parapara në secilin prej nënparagrafëve të nenit 41(6)(b) të Ligjit, çka nënkupton pranimin e mundësisë, e jo të pashmangshmërisë, se ato mund të ndodhin në të ardhmen.⁴⁷ Me fjalë të tjera, standardi që duhet të zbatohet është më i ulët se pashmangshmëria, por më i lartë se thjesht mundësia që rreziku të materializohet.⁴⁸ Gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të lirohet apo të mbahet në paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet të marrë parasysh masat alternative për parandalimin e rreziqeve të parapara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.⁴⁹

27. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, lidhur me parashtrimin e saj se vazhdimi i paraburgimit të z. Shala është i kundërligjshëm dhe kërkesën për lirimin e tij të menjëhershëm, Mbrojtja u qëndron plotësisht parashtrimeve të mëparshme.⁵⁰ Siç është saktësuar tashmë më lart dhe në vendimet e mëparshme të rishikimit të paraburgimit të z. Shala, Gjykatësit të Procedurës Paraprake nuk i kërkohet të bëjë konstatime për faktorët për të cilët tashmë është vendosur në vendimin fillestar për paraburgimin, dhe as të marrë parasysh parashtrimet që vetëm i përsërisin argumentet që janë trajtuar tashmë në vendimet e

⁴⁵ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 16, me referenca të mëtejshme.

⁴⁶ *Shih* pjesën e përgjithshme të nenit 41(6)(b) të Ligjit.

⁴⁷ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 16, me referenca të mëtejshme.

⁴⁸ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 16, me referenca të mëtejshme.

⁴⁹ KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017*, 26 prill 2017, publik, para. 114. *Shih gjithashtu* ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], no. 23755/07, [Judgment](#), 5 July 2016 (“*Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC]”), para. 87 *in fine*; ECtHR, *Idalov v. Russia* [GC], no. 5826/03, [Judgment](#), 22 May 2012, para. 140 në fund.

⁵⁰ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 7.

mëparshme.⁵¹ Prandaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk do t'i shqyrtojë këto parashtrime më tej dhe, rrjedhimisht, pjesët në vijim do të trajtojnë argumentet që nuk janë ngritur dhe shqyrtuar më parë.

1. Rreziku i arratisjes

28. Sipas ZPS-së, rreziku që i akuzuari të arratiset është shtuar në bazë të asaj se, përveç faktorëve të përcaktuar më herët të identifikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake: (i) procedurat vazhdojnë të përparojnë drejt kalimit të çështjes te Trupi Gjykses; (ii) ZPS-ja ka nxjerrë kohët të fundit provat e dëshmitarëve të tjerë, të cilët konfirmojnë përfshirjen e të akuzuarit dhe rolin e tij të rëndësishëm në kryerjen e krimeve të përfshira në aktakuzën e kësaj çështjeje.⁵² ZPS-ja gjithashtu parashtron se ndërkohë nuk ka pasur asnjë rrethanë që mund të ndryshojë arsyet në të cilat bazohen vendimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me rreziqet e renditura në nenin 41(6)(b) të Ligjit, përfshirë rrezikun e arratisjes.⁵³

29. Përveç përsëritjes së parashtrimeve të mëparshme,⁵⁴ Mbrojtja kundërshton parashtrimin e ZPS-së se rreziku i arratisjes është shtuar që nga Vendimi i Pestë i Paraburgimit, veçanërisht për shkak të ecures së procedurave.⁵⁵

30. Pas shqyrtimit të faktorëve dhe rrethanave të përmendura në vendimet për rishikimin e paraburgimit të z. Shala, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbetet i bindur se ato vazhdojnë të ekzistojnë. Më konkretisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se z. Shala: (i) është në dijeni të akuzave të rënda kundër tij, dënimit të rëndë që mund të rezultojë nga këto akuza në rast se shpallet fajtor, dhe

⁵¹ Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 24, 28, 32; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 24; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 18; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 33.

⁵² Parashtrimet e Prokurorisë, para. 5-6, *ku përmendet* Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 35-37-38, 40, 42-43; KSC-BC-2020-04, F00205, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2)*, 30 maj 2022, konfidencial.

⁵³ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 7.

⁵⁴ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 13.

⁵⁵ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 12.

vendimit të formës së prerë për fajësinë e dy anëtarëve të ndërmarrjes kriminale të përbashkët ("NKP") të cilës pretendohet se i përkiste edhe ai; dhe (ii) nuk pranon legjitimitetin e DHS-së.⁵⁶ Gjithashtu: (i) madhësia relativisht e vogël e grupit që përbën NPK-në e pretenduar dhe fakti që ngjarjet në të cilat bazohen akuzat janë lehtësisht të dallueshme e rrisin mundësinë e ndihmës së ndërsjellë midis anëtarëve të pretenduar të saj, përfshirë duke i ndihmuar njërit-tjetrit të arratisen; dhe (ii) ekziston një kontekst i përgjithshëm i një atmosfere të përgjithshme, të rrënjosur dhe të vazhdueshme, të ndërhyrjes në proceset penale që kanë të bëjnë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe të frikësimit të dëshmitarëve.⁵⁷ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se, në kundërshtim me parashtrimin e ZPS-së, rreziku i arratisjes nuk është shtuar si rezultat i ecuresë së procedurave, duke pasur parasysh se faktorët dhe rrethanat e lartpërmendura nuk varen në këto zhvillime. Për këto arsye, aktualisht vazhdon të ekzistojë rrezik i moderuar arratisjeje lidhur me z. Shala.

2. Rreziku i pengimit të ecuresë së procedurave të DHS-së

31. Lidhur me rrezikun e pengimit të procedurave të DHS-së, ZPS-ja paraqet të njëjtat argumente si edhe lidhur me rrezikun e arratisjes.⁵⁸

32. Përveç përsëritjes së parashtrimeve të mëparshme,⁵⁹ Mbrojtja parashtron se ZPS-ja përpiqet t'i paraqesë "rreziqet e shtuara" si pasojë e vetvetishme e ecuresë së procedurave, por nuk arrin të lidhë prova specifike me rreziqe specifike dhe me

⁵⁶ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 24-25; Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 28; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 25; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 27; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 35.

⁵⁷ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 26; Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 28; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 25; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 27; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 35. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07, F00611, Trupi Gjykses II, *Aktgjykim*, 18 maj 2022, konfidencial, me Shtojcat 1-3, publike, para. 576-578 (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, F00611/RED).

⁵⁸ *Shih* para. 28 më lart.

⁵⁹ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 13.

sjelljen e z. Shala, dhe as të identifikojë ndonjë rrezik konkret ose ndërhyrje konkrete të dëshmitarët e mbrojtur që nga arrestimi i z. Shala.⁶⁰

33. Rikujtohet se: (i) [REDAKTUAR];⁶¹ dhe (ii) ekzistenca e masave mbrojtëse nuk bie në kundërshtim me konstatimin se ekziston rreziku i pengimit në rrethanat e çështjes aktuale dhe, më përgjithësisht, domosdoshmëria për masa të tilla dëshmon një rrezik më të madh, duke qenë se ngjarjet në të cilat mbështeten akuzat janë lehtësisht të dallueshme.⁶²

34. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konsideron se, [REDAKTUAR], ecuria e procedurës paraprake pas Vendimit të Pestë të Paraburgimit – veçanërisht fakti që ZPS-ja pothuaj i ka përfunduar të gjitha obligimet e saj për nxjerrjen e materialeve në fazën e procedurës paraprake,⁶³ përfshirë nxjerrjen në kohët e fundit të identitetit të dëshmitarëve shtesë nga ZPS-ja⁶⁴ - shton rrezikun e pengimit duke pasur parasysh se kjo do t'i japë z. Shala informacion më të hollësishëm për çështjen kundër tij dhe me kalimin e kohës do të çojë në heqjen e disa masave mbrojtëse.⁶⁵

⁶⁰ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 12.

⁶¹ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 32-35; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 35-42; Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 32; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 29; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 30; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 33; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 37.

⁶² Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 31; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 29; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 31; Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 32, 34; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 37.

⁶³ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, publik, p. 299, rreshtat 1-6; F00204, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Hollësishëm i Prokurorisë për Procesin e Nxjerrjes së Materialit*, 27 maj 2022, publik. *Shih gjithashtu* Paketat nr. 61 (7 qershor 2022), 62 (10 qershor 2022) dhe 63 (14 qershor 2022) të nxjerra në *Legal Workflow*.

⁶⁴ KSC-BC-2020-04, F00169, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë në Pajtim me Rregullën 102(2) dhe për Ndryshimin e Listave të Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, 25 mars 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 mars 2022, F00169/RED); KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 272-273; F00205, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2)*, 30 maj 2022, konfidencial; Paketa nr. 61 e nxjerrë në *Legal Workflow* (7 qershor 2022); F00216, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listave të Ndryshuara të Dëshmitarëve dhe Provave Materiale*, 10 qershor 2022, konfidencial, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial i Shtojcave 1-2 u dorëzua më 13 qershor 2022, F00216/A01/CONF/RED dhe F00216/A02/CONF/RED).

⁶⁵ *Shih gjithashtu* Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 35-38.

35. Argumenti i përsëritur i Mbrojtjes se rreziku i shtuar pretendohet si pasojë e vetvetishme e ecurisë së procedurave,⁶⁶ shpërfill faktin se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të procedurave të DHS-së bazuar në: (i) [REDAKTUAR]; dhe (ii) zhvillime të caktuara lidhur me këtë çështje, që janë konstatuar se e rrisin këtë rrezik. Duke pasur parasysh konstatimet e lartpërmendura, nuk mund të thuhet se nuk janë identifikuar rreziqe konkrete dhe specifike të pengimit të ecurisë së procedurave të DHS-së. Për këto arsye, argumentet e Mbrojtjes hidhen poshtë.

36. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se rreziku që z. Shala të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së vazhdon të ekzistojë, duke u bazuar në [REDAKTUAR] dhe se me përparimin e fazës së procedurës paraprake z. Shala po merr më shumë njohuri për provat kundër tij.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

37. Sa i përket rrezikut të kryerjes së krimeve të tjera, ZPS-ja paraqet të njëjtat argumente si në lidhje me rrezikun e arratisjes.⁶⁷

38. Përveç argumenteve tashmë të përsëritura lidhur me dy rreziqet e nenit 41(6)(b) dhe përsëritjes së parashtrimeve të mëparshme,⁶⁸ Mbrojtja nuk paraqet parashtrime të tjera konkrete në Përgjigjen e Mbrojtjes lidhur me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera.

39. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk do të thotë automatikisht rrezik i kryerjes së krimeve të tjera, por thekson se faktorët në të cilët bazohet rreziku i parë janë të rëndësishëm edhe për vlerësimin e rrezikut të dytë në çështjen aktuale.⁶⁹ Sipas mendimit të Gjykatësit të

⁶⁶ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 12; *Shih gjithashtu* Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 39.

⁶⁷ *Shih* para. 28 më lart.

⁶⁸ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 13.

⁶⁹ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 39; Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 36; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 33; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 35; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 42.

Procedurës Paraprake, rreziku që z. Shala të kryejë krime të tjera vazhdon të ekzistojë, duke pasur parasysh se [REDAKTUAR].⁷⁰ Gjithashtu, sikurse me rrezikun e pengimit të procesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se ecuria e procedurës paraprake që nga Vendimi i Pestë i Paraburgimit, veçanërisht përfundimi nga ZPS-ja i obligimeve të nxjerrjes së informacionit në fazën e procedurës paraprake,⁷¹ përfshirë nxjerrjen para pak kohe të identitetit të dëshmitarëve shtesë nga ZPS-ja,⁷² e shton rrezikun që z. Shala të kryejë krime të tjera.⁷³ Argumentet e Mbrojtjes se faktorët e përmendur nga ZPS-ja janë të pamjaftueshëm nuk merren parasysh për të njëjtat arsye të përcaktuara më lart.⁷⁴ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se rreziku që z. Shala do të kryejë krimeve të tjera aktualisht vazhdon të ekzistojë.

4. Përfundim

40. Në kuadër të rishikimit të rregullt të paraburgimit të z. Shala në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqet që z. Shala të arratiset, të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së, ose të kryejë krime të tjera

⁷⁰ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 39; Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 36; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 33; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 35; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 42.

⁷¹ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, publik, p. 299, rreshtat 1-6; F00204, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Hollësishëm i Prokurorisë për Procesin e Nxjerrjes së Materialit*, 27 maj 2022, publik; F00215, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë lidhur me Nxjerrjen e Provave Shtesë në Përputhje me Rregullën 103*, 10 qershor 2022, Konfidencial. *Shih gjithashtu* Paketat nr. 62 (10 qershor 2022) dhe 63 (14 qershor 2022) të nxjerra në *Legal Workflow*.

⁷² KSC-BC-2020-04, F00169, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë në Përputhje me Rregullën 102(2) dhe për Ndryshimin e Listave të Dëshmitarëve dhe të Provave*, 25 mars 2022, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 mars 2022, F00169/RED); Transkripti, 14 prill 2022, konfidencial, f. 272-273; F00205, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit sipas Rregullës 102(2)*, 30 maj 2022, konfidencial; Paketa nr. 61 e nxjerrë në *Legal Workflow* (7 qershor 2022); F00216, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listave të Ndryshuara të Dëshmitarëve dhe të Provave*, 10 qershor 2022, konfidencial, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (versionet e redaktuara konfidenciale të Shtojcave 1-2 u dorëzuan më 13 qershor 2022, F00216/A01/CONF/RED dhe F00216/A02/CONF/RED).

⁷³ *Shih* para. 34 më lart.

⁷⁴ *Shih* para. 35 më lart.

kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë dëshmi për ZPS-në dhe/ose kanë për t'u paraqitur para DHS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të shqyrtojë më poshtë nëse këto rreziqe mund të trajtohen në mënyrë të përshtatshme duke vendosur kushte në lidhje me lirimin e përkohshëm të z. Shala.

D. LIRIMI ME KUSHT

41. ZPS-ja parashtron se rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit mund të zvogëlohen dhe menaxhohen në mënyrë efektive vetëm përmes vazhdimit të paraburgimit të të akuzuarit në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁷⁵ ZPS-ja parashtron se, për arsyet e përcaktuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në Vendimin e Pestë të Paraburgimit, arresti shtëpiak, dhe çfarëdo kushtesh për lirim të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake janë të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun e pengimit të procesit ose të kryerjes së krimeve të tjera, dhe se komunikimet e të akuzuarit mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm rreziqet vetëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHS-së.⁷⁶

42. Mbrojtja këmbëngul në qëndrimin e saj se mund të zbatohen masa të përshtatshme të cilat mund të zvogëlojnë në mënyrë të mjaftueshme çdo rrezik të mundshëm që paraqet lirimin e përkohshëm ose vendosja në arrest shtëpiak e z. Shala [REDAKTUAR] dhe përsërit gatishmërinë e z. Shala që të ofrojë zotime të shumta dhe t'u nënshtrohet kushteve që Gjykatësi i Procedurës Paraprake i konsideron të përshtatshme.⁷⁷

⁷⁵ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 9.

⁷⁶ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 8, *ku përmendet* Vendimit të Pestë të Paraburgimit, para. 52.

⁷⁷ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 16, 18.

43. Sa i përket rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se është konstatuar më parë që kushtet e propozuara lidhur me Vendimin e Parë të Paraburgimit e zvogëlojnë mjaftueshëm rrezikun, konkretisht zotimet e z. Shala që t'u nënshtrohet kontrolleve ditore nga zyrtarë të autorizuar belgë, t'i dorëzojë të gjitha dokumentet e udhëtimit, dhe t'i nënshtrohet monitorimit të rreptë nga autoritetet belge.⁷⁸ Duke pasur parasysh faktin se parashtrimet e përgjithshme të ZPS-së në lidhje me këtë çështje nuk janë të bazuara në prova, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi të ri në lidhje me këtë vendim, kushtet e lartpërmendura mbeten të përshtatshme për të zvogëluar rrezikun e arratisjes së z. Shala.

44. Duke iu kthyer rreziqeve të pengimit të ecurisë së procedurave të DHS-së dhe kryerjes së krimeve të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, edhe pse vë në dukje se kushtet e propozuara të Mbrojtjes janë trajtuar më parë dhe prandaj nuk ka nevojë të shqyrtohen më tej,⁷⁹ rikujton se është konstatuar se: (i) këto kushte nuk marrin parasysh mundësinë që z. Shala të përdorë mjete të komunikimit që i përkasin të tjerëve ose të kërkojë nga të tjerët që t'i përdorin mjetet e tyre për këto qëllime; dhe (ii) kushtet e zbatimit janë të pamjaftueshme për të siguruar monitorim efektiv të komunikimeve të z. Shala.⁸⁰ Nuk ka ndonjë informacion ose zhvillim të ri që justifikon ndryshimin e këtyre konstatimeve, veçanërisht për arsye se Mbrojtja nuk e saktëson pretendimin e saj të përgjithshëm se mund të zbatohen masa të përshtatshme.⁸¹

45. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij të mëparshëm se, pavarësisht çështjes nëse mundësia e arrestit shtëpiak do të zvogëlonte

⁷⁸ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 45; Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 40; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 37; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 39; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 46.

⁷⁹ Apeli i Paraburgimit të Haradinajt, para. 55; Vendimi i Apelit të Krasniqit, para. 17.

⁸⁰ Vendimi i Parë i Paraburgimit, para. 46-48; Vendimi i Parë i Gjykatës së Apelit, para. 53-58, 61; Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 41-42; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 38; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 40; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 47.

⁸¹ Përgjigja e Mbrojtjes, para. 16.

mjaftueshëm rreziqet e lartpërmendura, kjo masë nuk mund të zbatohet duke pasur parasysh përgjigjen e autoriteteve belge të dhënë në kontekst të Vendimit të Pestë të Paraburgimit.⁸²

46. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton konstatimin e tij se masat e vendosura në objektin e paraburgimit të DHS-së, parë në tërësi, ofrojnë garanci të forta sa u takon vizitave dhe komunikimeve të pambikëqyrura me anëtarë të familjes dhe me vizitorë të miratuar paraprakisht, me qëllim minimizimin e rreziqeve të pengimit të procesit dhe të kryerjes së krimeve të tjera sa më shumë që është e mundshme. Këto masa janë përshkruar në hollësi në Vendimin e Pestë të Paraburgimit.⁸³ Këto masa, si dhe masat shtesë, mund të urdhërohen *proprio motu* nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në përputhje me rregullën 56(6) të Rregullores. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson përsëri se Administratorja dhe paneli, të cilët kanë qasje të pakufizuar në informacionin konfidencial lidhur me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritete të tjera që veprojnë sipas një kornize të ndryshme.⁸⁴

47. Sa i përket kushteve shtesë që do të vendosen, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se Gjykata e Apelit ka saktësuar se duhet të vlerësohen të gjitha kushtet e *arsyeshme* që mund të vendosen për të akuzuarin.⁸⁵ Në këtë aspekt, duke mbajtur

⁸² Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 48, ku përmendet KSC-BC-2020-04, F00185/A02, Administratorja, Shtojca 2 e Përcjelljes së Korrespondencës (“Përgjigja e Autoriteteve Belge”), 19 prill 2022, konfidenciale, p. 2.

⁸³ Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 49. Shih gjithashtu Vendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit, para. 53; KSC-BC-2020-06, IA014-F00008, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit Lidhur me Rishikimin e Mbajtjes në Paraburgim dhe Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit*, 31 mars 2022, konfidencial, para. 38, 41, 44 (“Apeli i Paraburgimit të Veselit”) (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, IA014/F00008/RED).

⁸⁴ Shih gjithashtu *mutatis mutandis*, Apeli i Paraburgimit të Veselit, para. 41.

⁸⁵ KSC-BC-2020-06, IA017-F00011, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit Lidhur me Rishikimin e Paraburgimit*, 5 prill 2022, konfidencial, para. 51 (theksimi në origjinal), (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, IA017/F00011/RED).

parasysh përgjigjen e autoriteteve belge,⁸⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk është e mundur të vendosen as kushte shtesë që janë të arsyeshme dhe që do të mund të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet ekzistuese. Siç është konstatuar më herët, kushtet shtesë, si vizitat e mbikëqyrura nga autoritetet belge, janë veçanërisht [relevante] [të papërshtatshme] duke pasur parasysh faktin që z. Shala është në gjendje të komunikojë në një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare në Belgjikë.⁸⁷ Gjithashtu, duke pasur parasysh peshën e rreziqeve të përshkruara më lart, çfarëdo masash tjera më të buta se arresti shtëpiak me kushte shoqëruese mjaftueshmërisht të ngjashme me rregullat në objektin e paraburgimit të DHS-së, do të ishin të pamjaftueshme, ose aq jopraktike sa do të ishin të paarsyeshme. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se nuk ekzistojnë masa të tjera që do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet ekzistuese.

48. Prandaj, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbetet i bindur se komunikimet e z. Shala mund të kufizohen në një mënyrë që i zvogëlon rreziqet e lartpërmendura vetëm përmes kornizës së mbikëqyrjes së komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHS-së. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se kushtet e propozuara të vendosura nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake janë të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun që z. Shala të pengojë ecurinë e procedurave të DHS-së ose të kryejë krime të tjera.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

49. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit është i përligjur dhe proporcional meqenëse: (i) ndaj tij janë ngritur katër akuza për krime lufte dhe, nëse shpallet fajtor, mund të përballet me burgim të gjatë; (ii) rreziqet sipas nenit 41(6) të

⁸⁶ Përgjigja e Autoriteteve Belge, p. 2. Duke pasur parasysh qëndrimin e qartë të autoriteteve belge, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nuk nevojitet informacion shtesë për qëllime të vendimit aktual. *Shih gjithashtu* Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 51.

⁸⁷ Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 40; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 50.

Ligjit nuk mund të zvogëlohen jashtë objektit të paraburgimit të DHS-së; (iii) Gjykatësi i Procedurës Paraprake tashmë ka caktuar paraprakisht datën për kalimin e dosjes së çështjes te Trupi Gjykses; dhe (iv) ZPS-ja ka vazhduar t'i kryejë obligimet për nxjerrjen e informacionit, përfshirë përmbushjen e obligimeve të mbetura për nxjerrjen e informacionit në fazën e procedurës paraprake më 27 maj 2022.⁸⁸

50. Mbrojtja pretendon se vlerësimi i proporcionalitetit të paraburgimit të akuzuarit kërkon shqyrtimin e: (i) ndikimit të vazhdimit të paraburgimit tek z. Shala, përfshirë mungesën e vizitave të rregullta familjare dhe të pasojave financiare për familjen e tij si pasojë e paraburgimit të tij; dhe (ii) kohës së konsiderueshme që ka kaluar që nga Vendimi i Pestë i Paraburgimit, një faktor që kërkon shqyrtim konkret sa i përket ndërhyrjes në të drejtat e z. Shala për liri dhe mbrojtje të jetës së tij private dhe familjare.⁸⁹

51. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton rëndësinë e parimit të proporcionalitetit gjatë përcaktimit të arsyeshmërisë së paraburgimit në pritje të gjykimit dhe se, sa më gjatë që personi mbahet në paraburgim në pritje të gjykimit, aq më e madhe barra mbi ZPS-në që të justifikojë vazhdimin e paraburgimit.⁹⁰ Kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit është faktor që duhet të shqyrtohet së bashku me shkallën e rreziqeve që janë përshkruar në nenin 41(6)(b) të Ligjit, për të përcaktuar nëse, duke pasur parasysh të gjithë faktorët, vazhdimi i paraburgimit “pushon së qeni i arsyeshëm” dhe individit duhet të lirohet.⁹¹ Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, çështja nëse periudha kohore e kaluar në paraburgim në pritje të gjykimit është e arsyeshme, nuk mund të vlerësohet në mënyrë

⁸⁸ Parashtrimet e Prokurorisë, para. 10.

⁸⁹ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 14-15.

⁹⁰ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020, publik, para. 72-73.

⁹¹ *Ngjashëm* KSC-BC-2020-06, IA002/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit për Lirim të Përkohshëm*, 30 prill 2021, konfidencial, para. 69 (versioni i redaktuar publik u dorëzua të njëjtën ditë, IA002/F00005/RED).

abstrakte. Nëse është e arsyeshme që i akuzuari të mbahet në paraburgim ose jo, duhet të vlerësohet bazuar në faktet e secilit rast dhe sipas karakteristikave të tij konkrete.⁹²

52. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Shala ka qenë i paraburgosur në Belgjikë që nga data 16 mars 2021 dhe pastaj në objektin e paraburgimit të DHS-së që nga data 15 prill 2021; (ii) kundër tij janë ngritur katër akuza për krime lufte që pretendohet se ndodhën në Shqipëri gjatë disa javëve; (iii) ai mund të dënohet me burgim të gjatë, nëse shpallet fajtor; (iv) rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me kushtet e propozuara dhe/ose me çfarëdo kushtesh shtesë; (v) ZPS-ja në parim e ka përfunduar nxjerrjen e informacionit sipas rregullave 102(1)(b), 103 dhe 107 të Rregullores,⁹³ është dorëzuar Dosja Paraprake e ZPS-së si dhe tabela sipas rregullës 109(c) të Rregullores,⁹⁴ palët i kanë paraqitur pikat faktike për të cilat pajtohen,⁹⁵ dhe Mbrojtja ka bërë të ditur se nuk do të bëjë kërkesë për mundësi hetimore unike;⁹⁶ (vi) Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte caktuar paraprakisht një datë për t'ia kaluar çështjen Trupit Gjykses, konkretisht 31 majin 2022,⁹⁷ por kjo u shty për datën 31 gusht 2022 me kërkesë të Mbrojtjes, për shkak të vonesave të ZPS-në procesin e nxjerrjes së informacionit, hetimeve të Mbrojtjes në vijim e sipër, dhe kohës së kërkuar nga Mbrojtja për përgatitjen e Dosjes Paraprake;⁹⁸ dhe (vii) tri kërkesa të ZPS-së për masa mbrojtëse lidhur me materialin e rregullave 102(3), 103 dhe materialin e rregullës 102(1)(b), shtuar në pajtim me rregullën 102(2) të

⁹² ECtHR, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], para. 90.

⁹³ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, publik, f. 252-253, 268, 269, 287, 299, rreshtat 1-6 dhe 11-15; F00204, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Hollësishëm i Prokurorisë për Procesin e Nxjerrjes së Materialit*, 27 maj 2022, publik; F00215, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë lidhur me Nxjerrjen e Provave Shtesë në Përputhje me Rregullën 103*, 10 qershor 2022, konfidencial.

⁹⁴ KSC-BC-2020-04, F00135/A01, Prokurori i Specializuar, *Dosja Paraprake e Prokurorisë*, 28 janar 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 31 janar 2022, F00136/A01; versioni më pak i redaktuar konfidencial u dorëzua më 8 shkurt 2022, F00139/A01); F00144, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë i Tabelës sipas Rregullës 109(c)*, 11 shkurt 2022, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

⁹⁵ KSC-BC-2020-04, F00178, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Pikat Faktike për të Cilat ka Pajtueshmëri*, 8 prill 2022, publike, me një shtojcë, konfidenciale.

⁹⁶ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, publik, f. 279-280.

⁹⁷ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 4 mars 2022, publik, f. 242.

⁹⁸ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 prill 2022, publik, f. 276-300.

Rregullores, do të vlerësohen pa vonesë para se çështja t'i kalohet Trupit Gjykses.⁹⁹ Gjithashtu, në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Shala rishikohet çdo dy muaj, ose posa të ndodhin ndryshime në rrethana.

53. Sa i përket parashtrimeve të Mbrojtjes në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit të z. Shala, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka vlerësuar me kujdes kohën shtesë të kaluar në paraburgim nga z. Shala pas Vendimit të Pestë të Paraburgimit, përfshirë si pasojë detyrimin më të madh të ZPS-së për të justifikuar vazhdimin e paraburgimit të z. Shala. Sidoqoftë, kur krahasohet me faktorët e tjerë dhe, në veçanti, natyrën e rëndë të akuzave kundër z. Shala, pamundësia për të zvogëluar rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit dhe ecurinë e konsiderueshme të procedurave, kjo periudhë kohore nuk e bën paraburgimin e z. Shala joproportional. Gjithashtu, në lidhje me argumentet e Mbrojtjes bazuar në të drejtën e z. Shala për jetë private dhe familjare, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se tashmë ka konstatuar se: (i) shpeshësia e vizitave familjare nuk mund t'i atribuohet DHS-së dhe z. Shala ka mundësinë të komunikojë me anëtarët e familjes në mënyra të tjera; dhe (ii) mjeteve të kufizuara financiare në dispozicion të z. Shala duhet t'u jepet rëndësi e shumë e kufizuar në kontekst të çështjes aktuale.¹⁰⁰ Rrjedhimisht, argumentet e Mbrojtjes hidhen poshtë.

54. Mbi këtë bazë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se, për qëllimet e rishikimit të rregullt të paraburgimit të z. Shala në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, koha që z. Shala ka kaluar në paraburgim në pritje të gjykimit nuk është joproportionale. Gjithashtu, duke pasur parasysh se nuk është arritur pajtim në lidhje me fillimin e gjykimit, çdo diskutim

⁹⁹ [REDAKTUAR].

¹⁰⁰ Vendimi i Dytë i Paraburgimit, para. 48; Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 45; Vendimi i Katërt i Paraburgimit, para. 48; KSC-BC-2020-04, Transkripti, 14 janar 2022, publik, f. 181; Vendimi i Pestë i Paraburgimit, para. 57.

lidhur me kohëzgjatjen në tërësi të paraburgimit në pritje të gjykimit mbetet i parakohshëm dhe hamendësues.¹⁰¹

V. VENDIM

55. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Shala;
- (b) **URDHËRON** Mbrojtjen që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se **të hënën, 1 gusht 2022**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores;
- (c) **URDHËRON** ZPS-në që, nëse z. Shala vendos që të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të paraqesë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se **të hënën, 8 gusht**

¹⁰¹ *Shih gjithashtu Apeli i Paraburgimit të Krasniqit, para. 43; KSC-BC-2020-06, IA010-F00008, Gjykata e Apelit, Vendim mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Rishikimin e Paraburgimit, 27 tetor 2021, konfidencial, para. 51 (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, IA010-F00008/RED).*

2022 dhe z. Shala që, nëse dëshiron, t'i paraqesë parashtrimet e veta jo më vonë se të hënën, 15 gusht 2022; dhe

(d) URDHËRON ZPS-në dhe Mbrojtjen që të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të F00213 dhe F00221 deri të enjten, 30 qershor 2022.

_____/nënshkrimi/____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 22 qershor 2022

Në Hagë, Holandë.